



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

Nr. 81, datë 03.09.2020

**PËR
PËR SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË PARAQITUR NGA
SHOQËRIA "MRM" SH.P.K., KUNDËR VENDIMIT NR. 2 DATË 21.07.2020
VENDOSUR NDAJ SUBJEKTIT OSHMA "TV ME KABËLL KORÇA".**

Autoriteti i Mediave Audiovizive

I përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar

Mori në shqyrtim çështjen me:

Ankues: Shoqëria "MRM" sh.p.k.,

Objekt: Kundërshtim i vendimit për dënimin me gjobë të vendosur ndaj subjektit OSHMA "Tv me kabëll Korça", me nr. 2, datë 21.07.2020.

Baza Ligjore: Ligji nr. 97/2013 Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimi nr. 101 datë 07.06.2017 të AMA-s "Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv. Kodi i procedruave administrative i Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 10 279, datë 20.05.2019 "Për kundravajtjen Administrative".

Në datën 18.07.2020, grupi i inspektimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, sipas urdhrimit të Kryetarit të AMA-s, nr. 115, datë 13.07.2020 "Për inspektimin e veprimtarisë së subjekteve (OSHMA), inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimtarive të palicencuara/paautorizuara", ka kryer një kontroll të veprimtarisë audiovizive mbështetur në rrjet kabllor në njësinë administrative Voskop. Nga ky kontroll u

konstatua se në këtë njësi administrative ushtron akitivet audioviziv shoqëria “MRM” sh.p.k, autorizuar për subjektin “Tv me kabëll Korça”.

Subjekti OSHMA “Tv me kabëll Korça”, është autorizuar nga AMA për ofrimin e shërbimit audioviziv të mbështetur në rrjet kabllor në njëstë administrative Korçë, Maliq, Drenovë, Libonik dhe Bulgarec. Nga verifikimet e kryera në datën 18.07.2020 është konstatuar se subjekti në fjalë, ushtron akitivet audioviziv edhe në njësinë administrative Voskop fakt ky që vërtetohet nga procesverbalet e inspektimit të nënshkuara nga përfaqësuesi i subjektit.

Duke u mbështetur në nenin 133, pika 3/c të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:

Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga i licencuari ose i autorizuari, kur nuk përbëjnë veprë penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

3. Me gjobë nga 1 000 000 deri në 3 000 000 lekë për rastet kur:
c) transmeton nga vende të ndryshme nga ato të përcaktuara në licencë.

Sa më lart, konkludohet se shoqëria “MRM” sh.p.k., autorizuar për subjektin OSHMA “Tv me kabëll Korça” ka ofruar shërbim audioviziv mbështetur në rrjet kabllor jashtë zonës për të cilën është autorizuar nga AMA.

Në këto kushte, ndaj subjektit në fjalë është proceduar me Vendimin nr. 2 datë 21.07.2020, duke e dënuar me gjobë atë në masën 1.000.000 (një milion) lekë.

Kundër këtij vendimi, me shkresën nr. 2005/2 prot. datë 19.08.2020, subjekti ka paraqitur ankim administrativ, ndër të tjera duke pretenduar se:

Ne deklarojmë me përgjegjësi se mos përfundimi i “Procesit të licencimit për të zhvilluar akitivet tregtar nëpërmjet ofrimit të programeve ndaj publikut me rrjet kabllor në zonën e Voskopit ka ngecur i pa përfunduar për shkaqe objektive të cilat po i rëndisim sa më poshtë:

- *Në muajin shkurt 2020 një “Grup inspektimi” nga AMA gjatë një kontrolli rutinë ka konstatuar se një operator i pa licencuar kryente në zonën Voskopit Korçë akitivet tregtar nëpërmjet ofrimit të programeve ndaj publikut me rrjet kabllor. Veprimet e organeve tuaja (të AMA-s) vendosën mbylljen e akitivetit për këtë operator që vepronte pa licencë të AMA-s dhe pa deklaruar akitivetin tregtar në organet fiskale.*
- *Në këto rrethana nga stafi i drejtimit të (shoqërisë MRM sh.p.k.) u pa e arsyeshme që të zgjerohej akitiveti i shërbimeve nëpërmjet ofrimit të programeve ndaj publikut me rrjet televiziv kabllor duke mbuluar edhe zonën e Voskopit.*
- *Për këto arsye në muajin Shkurt 2020 filloi puna përgatitore nga stafi i shoqërisë tregtare “MRM” sh.p.k, për të plotësuar të dhënat e kërkuara “dosjen e aplikimit për shtesë zone mbulimi” në përputhje me kërkesat ligjore me qëllim (subjekti OSHMA “Tv kabllor Korça”) të licencohej në një afat sa më të shkurtër për të kryer akitivet tregtar nëpërmjet ofrimit të programeve ndaj publikut me rrjet televiziv kabllor duke mbuluar edhe zonën e Voskopit.*
- *Në datën 12 Mars deri në fund të Qershorit 2020 akitivet tregtare u tkurrën dhe shumë prej tyre u ndërprejnë. Gjithashtu midis operatorit që vepronte pa licencë dhe shoqërisë “MRM” sh.p.k., që kërkon të licencohej për kryerje akitiveti në këtë zonë mbulimi lindën konfliktet lidhur me investimet që kishte realizuar në terren*

“operatori që kryente aktivitet shërbimi të pa licencuar nëpërmjet ofrimit të programeve ndaj publikut me rrjet televiziv kabllor duke mbuluar edhe zonën e Voskopit.

- *Konfliktet për pronësinë e investimeve të kryera nga operatori që vepron pa licencë dhe shoqërisë “MRM” sh.p.k., kanë krijuar shumë pengesa dhe pasiguri të cilat vonuan shumë fillimin faktik të aktivitetit tregtar për transmetim nga OSHMA “TV Kabllor Korça”. Vetëm në muajin Korrik u nënshkrua kontrata përfundimtare me të licën prej shoqërisë “MRM” sh.p.k., u blenë të gjitha asetet e investuara nga personat që kryenin aktivitet tregtar për ofrimin e programeve ndaj publikut me rrjet televiziv kabllor duke mbuluar zonën e “Voskopit”. Kjo gjë vërtetohet nga fakti që Grupi i inspektimit të AMA-s në momentin e kontrollit gjeti plotësisht të përfunduar e të gatshme për tu dorëzuar në AMA dosjen e aplikimit që subjekti oshma tv kabllor Korça të licencohej për të kryer aktivitet nëpërmjet ofrimit të programeve ndaj publikut me rrjet televiziv kabllor duke mbuluar edhe zonën e Voskopit.*
- *Aktualisht dosja e aplikimit e përgatitur prej shoqërisë “MRM” sh.p.k., që subjekti OSHMA “Tv me kabëll Korça” të licencohej prej AMA-s për të kryer aktivitet tregtar nëpërmjet ofrimit të programeve televizive ndaj publikut në rrjet televiziv kabllor duke mbuluar edhe zonën e Voskopit është depozituar për shqyrtim në “Autoritetet kompetente të licencimit të AMA-s” dhe pritet përgjigje nga institucioni juaj.*

Pas njohjes me pretendimet e palës ankuese, konstatohet së pari se, me faturë të lëshuar nga AMA me nr. 192 datë 20.01.2020 për përpunim dokumentacioni, subjekti ka kryer pagesë për zgjerim zone të ofrimit të shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor për zonat Voskop dhe Mollaj.

Së dyti me shkresat nr. 1998 prot., datë 20.07.2020 dhe nr. 2206 prot., datë 13.08.2020 subjekti ka depozituar pranë AMA-s aplikim për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit për zonat Voskop dhe Mollaj.

Së treti, subjekti ka plotësuar dosjen në përputhshmëri me kërkesat ligjore të cdo drejtorie pranë AMA-s, dhe është e plotë për tu shqyrtuar nga bordi.

Së katërti, pala ankuese, shoqëria “MRM” sh.p.k., ka nënshkruar një autorizim me shoqërinë “TRING” sh.a., me datë 01.07.2020, shoqëri e cila ka kryer ankim pranë AMA-s për ushtrimin aktivitetit të paligjeshëm në zonën e Voskopit, për respektimin e të drejtave të transmetimit edhe për zonat Voskop dhe Mollaj.

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16, nenit 133, pika 11 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe rregullores “Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”, miratuar me Vendimin nr. 101 datë 07.06.2017 të AMA-s, Autoriteti i Mediave Audiovizive.

VENDOSI:

1. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e vendimit nr. 2 datë 21.07.2020 për dënimin me gjobë, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, të shoqërisë “MRM” sh.p.k., për subjektin OSHMA “Tv me kabëll Korça”.
 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, duke filluar nga dita e marrjes dijeni.
 3. Ky vendim përbën titull ekzekutiv.
 4. Ngarkohet administrata e AMA-s për veprime të mëtejshme sipas ligjit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar: Gentian

SALA

Zëvendëskryetar: Sami

NEZAJ

Anëtarë: Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA

Agron

GJEKMARKAJ